



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e XIII-të për vitin 2012, e Kuvendit Komunal në Vushtrri, mbajtur më 27.12.2012

Mbledhja është mbajtur në sallën e kuvendit komunal duke filluar në orën 10:10. Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtrri: Arta Ismajli, Avdullah Halimi, Besim Jashari, Esat Beka, Ferit Idrizi, Gani Imeri, Gjylsime Feka, Habib Mustafa, Habibe Gërzhaliu, Hajrulla Muli, Islam Krasniqi, Ismet Gashi, Makfirete Ademi, Merjeme Ismajli, Melihate Basholli, Muharrem Shabani, Naile Osmani, Nysret Gërzhaliu, Pajazit Pllana, Qazim Azemi, Refik Ramaj, Remzije Isufi, Sabit Kadriu, Sabri Ferati, Selim Rustemi, Selvete Sholla, Shpëtim Zhegrova, Syzana Sylja, Tasim Gubetini, Veli Karaça, Xhemajl Pllana dhe Zeqir Hasani.

Munguan: Bahrije Pllana, Ergin Sunguri dhe Vlora Qirezi, anëtarë të kuvendit.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe: kryetari i komunës, drejtorët e drejtorive komunale, përfaqësuesi i OSBE-së dhe përfaqësues të mediave të shkruara dhe të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Habib Mustafa - kryesues i kuvendit, i cili vërtetoi se ka shumicë për punë dhe hapi debatin për rendin e ditës.

Sabit Kadriu, anëtar i kuvendit- tha se zakonisht në fund të vitit (nëpër vendet ku ka demokraci dhe transparencë) paraqiten raporte të drejtorive, të cilat bëjnë bilanc të rezultateve të arritura, prandaj ka qenë e nevojshme të paraqitej një raport që pasqyron bilancin e të arriturave dhe të paarriturave.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës- duke iu referuar vërejtjes së S.Kadriut, sqaroi se nuk është një praktikë paraqitja e raportit të qeverisë komunale në fund të vitit, pasi që është e planifikuar me planin e punës së kuvendit, që raporti në fjalë të paraqitet në vitin e ardhshëm, dhe shtoi se qeveria komunale brenda vitit dy herë ka realizuar takime me qytetarë (ku kanë qenë të ftuar për pjesëmarrje të gjithë anëtarët e kuvendit) dhe aty janë debatuar të gjitha projektet e realizuara.

Besim Jashari, anëtar i kuvendit- paraqiti vërejtje lidhur me rekomandimet e paraqitura në shkresën e adresuar nga KPF-ja, sepse nga shkresa në fjalë nuk mund të kuptohet se ku përfundon numri i pikave të shqyrtuara nga KPF-ja. Po ashtu pyeti pse KPF-ja nuk i ka marrë në shqyrtim: Draft-rregulloren për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale dhe kërkesën e kryetarit të komunës për rishqyrtim të Vendimit të

kuvendit të komunës nr. 297/12, dt.30.10.2012, dhe shtoi se kjo kërkesë për rishqyrtim të vendimit (të kuvendit komunal) ka ardhur në kuvend, pasi që MAPL-ja ka treguar se vendimi në fjalë ka qenë jo i rregullt, i kundërligjshëm dhe në kundërshtim me udhëzimin administrativ, ku tha se Grupi Asambleist i LDK-së (edhe në mbledhjen e kaluar të KK-së) ka kundërshtuar marrjen e vendimit në atë mënyrë, por ai kundërshtim nuk është marrë parasysh nga kryetari i komunës. Prandaj rishqyrtimi i këtij vendimi në këtë seancë është vërejtje serioze për kryetarin e komunës, i cili përkundër argumenteve që janë dhënë se ky vendim nuk është në harmoni me udhëzimin administrativ, prapë ka insistuar dhe është marrë vendim me shumicë votash.

Refik Ramaj, anëtar i kuvendit- në emër të Grupit parlamentar të LDK-së reagoi në lidhje me një prononcim të kryetarit (gjatë një diskutimi publik me qytetarë), duke u pajtuar me një qytetarë, ku mosardhjen e këshilltarëve komunal e ka kualifikuar si mungesë të mëditjes dhe shtoi se kjo është ofenduese, dhe shtoi se kryetari i komunës është dashtë ta sqarojë se nuk është i rregulluar me ligj arsyetimi (te punëdhënësi) për mungesën në punë të këshilltarëve komunal, për të qenë prezent në tubimin me qytetarë.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës- tha se vërejtja e B.Jasharit nuk qëndron, pasi që draft-rregullorja në fjalë ka qenë në KPF, pastaj ka qenë në kuvendin e komunës për shqyrtimin e parë, prandaj nuk është e nevojshme që përsëri të procedohet përmes KPF-së para se të shqyrtohet për të dytën herë në kuvend.

Besim Jashari, anëtar kuvendit- përsëri e mbrojti qëndrimin e tij se pasi që daft-rregullorja ka qenë në diskutim publik, është dashtë të kalojë përmes KPF-së, pastaj të vjen në kuvend. Mandej lidhur me rishqyrtimin e vendimit të kuvendit të komuna, tha se është dashtë të ceket se Grupi Asambleist i LDK-së e ka adresuar çështjen tek MAPL-ja, dhe pas shqyrtimit të argumenteve, ka ardhur në përfundim se vendimi ka qenë në kundërshtim me udhëzimin administrativ.

Në përfundim të diskutimeve rreth rendit të ditës, kuvendi me vota unanime miratoi këtë:

R E N D I T E

- 1. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja e rregullt e KK-së, mbajtur më 22.11.2012.**
- 2. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e KK-së, mbajtur më 12.12.2012.**
- 3. Shqyrtimi i Draft-rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale (shqyrtimi i dytë).**
- 4. Shqyrtimi i Draft-rregullores për procedurat dhe kriteret e vendosjes dhe mirëmbajtjes së përmendoreve, shtatoreve, busteve dhe simboleve (shqyrtimi i dytë).**
- 5. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për caktimin e interesit të përgjithshëm për vendosjen e varrezave të qytetit (Zona Kadastrale Vushtrri).**
- 6. Shqyrtimi i Informatës lidhur me realizimin e të hyrave vetanake për muajt tetor-nëntor 2012.**
- 7. Shqyrtimi i Draft-planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2013.**
- 8. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për vendosjen e ndriçimit publik në qytet dhe fshatra, në vendet ku ka participim nga ana e qytetarëve.**
- 9. Shqyrtimi i dy peticioneve: peticioni i grupit të qytetarëve kundër lejimit të ndërtimeve të larta, në kundërshtim me rregullat urbanistike dhe peticioni i**

banorëve të fshatit Stanoc i Poshtëm për parandalimin e ndërtimit të "Shtëpisë pushuese".

10. Shqyrtimi i kërkesës së kryetarit të komunës për rishqyrtimin e vendimit nr. 297/12, dt. 30.10.2012.

11. Të ndryshme.

Në vazhdim, u diskutuan së bashku këto pika të rendit të ditës:

1. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e KK-së, mbajtur më 22.11.2012.

2. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e KK-së, mbajtur më 12.12.2012.

Aprovohen unanimisht dy procesverbalet në fjalë, pa vërejtje dhe sugjerime nga anëtarët e kuvendit.

3. Shqyrtimi i Draft-rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale (shqyrtimi i dytë).

Refik Ramaj, anëtar i kuvendit- tha se Grupi parlamentar i LDK-së ka premtuar që do të zhvillohet një komunikim me komunitetin e biznesit (veçanërisht me bizneset e suksesshme) për ta propozuar një version, por premtimi i kryetarit të komunës ishte që të ftohen në takim përfaqësuesit e grupeve parlamentare, mirëpo kjo nuk ka ndodhur. Pastaj tha se Grupi parlamentar i LDK-së ka zhvilluar debat dhe analizë të kësaj rregulloreje, duke u konsultuar edhe me komunitetin e biznesit dhe shtoi se qëndrimi i Grupit parlamentar të LDK-së, duke u mbështetur në objektivat e komunës, që komuna të krijojë një ambient të favorshëm ndërmarrës, dhe duke u mbështetur në shembujt pozitiv të shteteve të zhvilluara dhe Bashkimit Evropian, propozoi që të hiqet taksa vjetore komunale e bizneseve, pasi që në këtë stad të zhvillimeve, nuk ka nevojë që bizneset të ngarkohen me taksë komunale, dhe shtoi në shtetet e Bashkimit Evropian, jo vetëm që nuk ka taksë komunale, por edhe në shtetet që nuk janë anëtarë të Bashkimit Evropian, dhe përmendi Zvicrën ku me rastin e regjistrimit të bizneseve për herë të parë, në tri vitet e para i liron nga të gjitha obligimet (duke përfshirë edhe lirin nga fitimi në tatim), gjithashtu edhe Italia dhe Franca i liron.

Zeqir Hasani, anëtar i kuvendit- tha se duke pasur parasysh trendet e zhvillimit ndërkombëtar, rekomandimet e FMN-së, si dhe sponsorimet e USAID-it për favorizimin dhe stimulimin e zhvillimit të bizneseve, propozoi që taksat në firmë për biznese të hiqen tërësisht, me qëllim të stimulimit të një zhvillimi ekonomik më të hovshëm dhe të rritjes së punësimit.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit- tha se Grupi parlamentar i PDK-së ka shqyrtuar draft-rregulloren në fjalë dhe ka ardhur në përfundimin për lirin e disa bizneseve nga taksa komunale, duke propozuar që nenit 8 t'i hiqen: alineja 1.4, 1.9, 1.10, 1.23, 1.35, 1.44, 1.49, 1.53, 1.59, 1.67, 1.68, 1.69, 1.75, 1.79, 1.80, 1.87, 2.2, 2.3, 2.5, 2.8 dhe 2.10.

Pajazit Pllana, anëtar i kuvendit- duke iu referuar draft-rregullores në fjalë, te neni 8, alineja 1.30, tha se nuk shkojnë së bashku shërbimet bujqësore dhe shëndetësore, prandaj propozoi që të ndahen njëra prej tjetrës. Pastaj te veprimtaritë profesionale, ka paraqitur dy vërejtje, duke shtuar se ordinancat duhet të ndahen në ordianca **specialistike** të mjekësisë familjare, specialistike kirurgjike dhe ato të tipit diagnostiko, duke propozuar këtë radhitje në: 3.1 ordianca e mjekësisë familjare; 3.1.1 ordiancat specialistike pediatrie, internistike; 3.1.2 Ordiancat stomatologjike të përgjithshme; 3.1.3 ordiancat stomatologjike specialistike; 3.1.4 ordiancat

gjinekologjike kirurgjike, otorinolaringologjike; 3.1.5 diagnostika me röntgen; 3.1.6 laborator dhe 3.1.7 qendra diagnostike, dhe shtoi se ata që kanë përfitime më të mëdha dhe që kanë shërbime më të shtrenjta, ata të paguajnë më shumë, kurse ata të mjekësisë familjare dhe të tjerët më pak. Gjithashtu propozoi që të zbritet taksa për 50 % për shërbyesit me rekomandim profesional. Në fund lidhur me nenin 32, alineja 1.18, tha se nuk janë të realizueshme, kurse lidhur me alinenë 1.19, tha se duhet të specifikohen për çka kërkohet dhe kush e kërkon, ndërsa në alinenë 1.20, tha se duhet të specifikohet.

Ismet Gashi, anëtar i kuvendit- duke iu referuar nenit 6 të draft-rregullores në fjalë, tha se është mirë në çdo nen ku parashihen taksat dhe tarifat për atë drejtori, të përmendet edhe emri i drejtorisë; te neni 7.3, tha se nuk ka paragraf të cilit i referohet ky nen; nenit 10.3 propozoi që t'i shtohet kjo fjali: "përveç fshatrave që janë të përfshira në zonë e IV-të"; te neni 33, propozoi që të emërtohet ndryshe ky nen; duke iu referuar përmbajtjes së nenit 33.3, tha se nuk janë pjesë përbërëse, prandaj është dashur të cekën.

Qazim Azemi, anëtar i kuvendit- duke iu referuar draft-rregullores në fjalë, tha se në shqyrtimin e parë i ka paraqitur disa vërejtje lidhur me rrjetin kabllovik dhe me bankat, ku ka propozuar një tarifë më të lartë. Kurse te neni 7 propozoi që për alinenë 1.6 ngarkesa të jetë 1 €; te alineja 1.26 dhe 1.27, propozoi që të zvogëlohen tarifat.

Habib Mustafa, kryesues i kuvendit- lexoi draft-rregulloren në fjalë nen për nen, duke iu dhënë mundësinë anëtarëve të kuvendit për plotësime dhe ndryshime eventuale.

Sabit Kadriu, anëtar i kuvendit- duke iu referuar draft-rregullores në fjalë, paraqiti këto propozime: te neni 7, alineja 1.2 propozoi që nga 7 € të rritet në 10 €; te alineja 1.6 propozoi të jetë 1 € ose të hiqet tërësisht; te alineja 1.26 propozoi që shuma të zbritet në 5 €.

Hajrulla Muli, anëtar i kuvendit- duke iu referuar nenit 7, alineja 1.2 propozoi që shuma të hiqet tërësisht.

Idriz Muzaqi, drejtor i Drejtorisë për Administratë- lidhur me propozimet dhe vërejtjet e anëtarëve të kuvendit, paraqiti sqarime shtesë lidhur me nenin 7 të draft-rregullores në fjalë.

Nasuf Aliu, drejtor i Drejtorisë për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim- paraqiti sqarime shtesë lidhur me çështjen e bizneseve aktive dhe pasive.

Sabit Kadriu, anëtar i kuvendit- lidhur me nenin 32, tha se na ka rastisur të jemi në ordinanca private dhe shtetërore, dhe askund nëpër mure nuk ekzistojnë tarifat apo taksat të cilat duhet t'i paguajnë klientët që shkojnë për vizitë, prandaj është mirë që në ordinancat private të figurojnë tarifat për çdo shërbim.

Melihate Basholli, anëtare e kuvendit- lidhur me draft-rregulloren në fjalë, te neni 34.2 propozoi që çmimet për fëmijët që shkojnë në çerdhe të mbesin ashtu siç kanë qenë më parë, dhe të ceket që fëmija i katërt të jetë falas në çerdhe.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 17 vota "për", 12 "kundër", të tjerët "abstenim" vendosi me sa vijon:
Aprovohet Rregullorja për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale, duke inkorporuar shumicën e propozimeve të anëtarëve të kuvendit.

4. Shqyrtimi i Draft-rregullores për procedurat dhe kriteret e vendosjes dhe mirëmbajtjes së përmendoreve, shtatoreve, busteve dhe simboleve (shqyrtimi i dytë).

Veli Karaça, anëtar i kuvendit- tha se Grupi parlamentar i LDK-së e mbështet draft-rregulloren në fjalë dhe vlerëson se me këtë rregullore po rregullohet një çështje mjaft e rëndësishme, e cila deri më tash nuk ka qenë e rregulluar.

Sabit Kadriu, anëtar i kuvendit- duke i referuar draft-rregullores në fjalë, tha se është mirë që të përfshihet edhe termi "lapidar".

Qazim Azemi, anëtar i kuvendit- duke i referuar draft-rregullores në fjalë, te neni 2 propozoi t'i shtohet përkufizimi për "monumentin e ngrirë".

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Aprovohet Rregullorja për procedurat dhe kriteret e vendosjes dhe mirëmbajtjes së përmendoreve, shtatoreve, busteve dhe simboleve.

5. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për caktimin e interesit të përgjithshëm për vendosjen e varrezave të qytetit (Zona Kadastrale Vushtrri).

Rushit Bilalli, zyrtar nga Drejtoria për Shërbime Publike- paraqiti sqarimet hyrëse lidhur me propozim-vendimin në fjalë, dhe propozoi që në vend të 10 hektarëve të përfshihen në vendim 26 hektarë.

Ismet Gashi, anëtar i kuvendit- lidhur me propozim-vendimin në fjalë, tha se nuk mund të bëhet në këtë formë shpallja e interesit të përgjithshëm, nëse nuk thirremi edhe në dispozitat ligjore, të cilat parashohin këmbimin e pronës komunale me pronën shoqërore (kooperativës bujqësore), prandaj propozoi që neni 10, paragrafi 1.1 të Udhëzimit Administrativ nr.202/2012 për zbatimin e Ligjit për këmbim dhe dhënie në shfrytëzim të pronës komunale, të ceket në nenin 3 të propozim-vendimit në fjalë, që obligohet kryetari i komunës për të zhvilluar procedurat konform dispozitave ligjore për realizimin e këtij vendimi, pasi që komuna duhet t'ia ofrojë AKP-së një pronë, për t'ia marrë një pronë tjetër.

Haki Maloku, përgjegjës i sekretarisë- duke i referuar propozimit të R.Bilallit për propozimin për dy parcela, tha se pasi që janë të ndara në dy parcela, është e panevojshme që të hyjnë të dyjat, dhe shtoi se mjafton parcela e parë që është rreth 22 hektarë. Po ashtu njoftoi se ka dalë Ligji i ri për dhënien e pronave në shfrytëzim dhe këmbim, me ç'rast tha se nuk kemi të bëjmë me këmbimin e pronave, por me rikthimin e pronave të ish-ndërmarrjeve që janë në evidencë të AKP-së, për rikthimin në pronësi të komunës.

Sabit Kadriu, anëtar i kuvendit- tha se me qëllim që të ruhen tokat, sidomos tokat bujqësore, duhet të vazhdohet atje ku janë varrezat dhe rikujtoi propozimin e tij të mëparshëm që gjatë procedurës së varrimit, kufomat të futen në qese që janë enkas për kufomat dhe nuk do të ketë erë të kufomave, me ç'rast shtoi se as në vendin që do të vendosen varrezat nuk është bërë një studim nga inxhinierët, që do të na siguronte që varrezat në lokacionin e ri nuk do të kundërmonin sikurse varrezat aktuale.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës- duke i referuar propozim-vendimit në fjalë, tha se me këtë vendim synohet të shpallet zonë e interesit, dhe kjo parcelë i dedikohet varrezave të reja, për shkak të problemeve që janë paraqitur lidhur me kundërmim në varrezat aktuale.

Besim Jashari, anëtar i kuvendit- tha se kur të ngrihen çështjet për shpalljen e zonave të caktuara me interes të përgjithshëm, është mirë që arsyeshmëria të jetë e qëndrueshme, duke shtuar se nganjëherë po nënvlerësohet roli dhe fuqia e kuvendit komunal, sepse kuvendi komunal është organi më i lartë në komunë dhe fuqia e vendimeve të tij është shumë e rëndësishme. Prandaj vendimet e kuvendit duhet të jenë të bazuara dhe të argumentuara fuqishëm, pasi që AKP-ja do ta merrte parasysht çdo vendim të kuvendit të komunës, nëse vendimet e aprovuara janë të argumentuara me fakte, ekspertizë dhe analiza. Gjithashtu tha se komuna duhet t'ia paraqesë AKP-së projekte konkrete dhe të detajuara.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit- tha se planifikimin edhe për të gjallët edhe për të vdekurit e ka në përgjegjësi që ta bëjë komuna në kuadër të zhvillimit të

përgjithshëm, dhe në rastin konkret duhet të mendohet për një etapë më të gjatë, dhe pasi që parcela është 22 hektarë, propozoi që kjo parcelë të përfshihet si e tillë, por shtoi se arsyetimi duhet të jepet duke u bazuar në peshën dhe rëndësinë e çështjes për qytetarët dhe Komunën e Vushtrrisë. Prandaj kuvendi i komunës duhet të aprovojë vendimin, kurse organet komunale obligohen të ndër marrin të gjitha procedurat deri te projekti detal, që të kemi aso varreza, siç i ka hije një populli të civilizuar.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 31 vota "për", 1 "kundër" vendosi me sa vijon:

Me këtë vendim caktohet interesi i përgjithshëm në pronën e paluajtshme si vijon: Numri i fletëtreguesit 600, numri i parcelës 4182-0 nr. i protokollit 18/4779, Zona Kadastrale Vushtrri, me kulturë arë, klasa 6, pjesë nga parcela në sipërfaqe prej 22.76.28 ha, pronë e Kooperativës Bujqësore në Vushtrri.

6. Shqyrtimi i Informatës lidhur me realizimin e të hyrave vetanake për muajt tetor-nëntor 2012.

Zeqir Hasani, anëtar i kuvendit- duke iu referuar të dhënave të paraqitura në informatën në fjalë, tha se shihet se ka realizim të të hyrave në shkallën prej 65 %, që d.m.th se nuk ka realizim të planifikuar, prandaj për të ardhmen kërkoi nga qeveria lokale që të bëjë planifikim më real të të hyrave vetanake. Pastaj tha se përveç tri drejtorive: Drejtorisë për Buxhet, Drejtorisë për Administratë dhe Drejtorisë për Arsim, të cilat kanë realizuar dhe tejkaluar planin, të gjitha drejtoritë tjera janë nën plan, sa i përket realizimit të të hyrave vetanake, prandaj rekomandoi që drejtoritë në fjalë ta shtojnë angazhimin dhe të fokusohen sidomos në mbledhjen e të hyrave nga tatimi në pronë. Gjithashtu (për të ardhmen) i propozoi qeverisë lokale që të mos bazohet në mbledhjen e taksës në firmë, sepse sipas rekomandimeve të fundit të FMN-së, ato taksa duhet të hiqen si ngarkesa për biznese. Mandej tha se sipas tabelarëve të të hyrave vetanake për 11 muajt e vitit 2012, shihet se qeveria lokale (në bazë të planifikimit për mbledhjen e të hyrave vetanake) ka dështuar në realizimin e planeve, sa i përket mbledhjes së të hyrave vetanake.

Refik Ramaj, anëtar i kuvendit- duke iu referuar informatës në fjalë, tha se është brengosëse dhe e pajustificuar që ka gabime teknike në tabelar, ku te tabela e parë thuhet muaji, por nuk ceket cili muaj, dhe shtoi se edhe më drastike është dallimi në mes të buxhetit të planifikuar dhe planit të reviduar, pasi që pyeti se ku mund të krahasohet diçka, kur nuk ekziston njëra prej këtyre krahasimeve. Pastaj tha se konkluzioni i Grupit parlamentar të LDK-së është se ka dështuar në një masë të konsiderueshme mbledhja e të hyrave vetanake, po ashtu (duke iu referuar planit të punës) donacionet e brendshme kanë një përqindje jashtëzakonisht të ulët të realizueshmërisë, apo 92 % të dështimit, dhe kjo është shqetësuese, pasi që janë dy arsye: ose nuk ka atmosferë të favorshme investuese në Komunën e Vushtrrisë, ose ka mungesë të besimit në institucionin e komunës, ndërkaq realizimi (në total) i të hyrave vetanake në 65 % kërkon një analizë serioze nga strukturat komunale, në veçanti nga Drejtoria për Buxhet dhe nga kryetari i komunës për t'i gjetur shkaqet dhe arsyet që kanë çuar në realizim kaq të dobët, dhe në mënyrë të veçantë do të duhej analizuar struktura e ponderuar e të hyrave vetanake, në mënyrë që të merren mësim për planifikimet e ardhshme. Po ashtu shtoi se të hyrat vetanake në këtë periudhë kanë një ngecje prej 27 %, por kjo përqindje është shumë më e madhe, sepse ka vjelje të viteve të kaluara.

Qazim Azemi, anëtar i kuvendit- paraqiti disa vërejtje teknike lidhur me informatën në fjalë, duke shtuar se 10 tabelat e paraqitura në informatë, është dashtë të përcillen me komente të shkurta. Pastaj tha se ka dështim në realizimin e këtyre të ardhurave, prandaj është dashtë të ketë arsyetim pse ka ndodhur ky dështim.

Besim Jashari, anëtar i kuvendit- duke i referuar informatës në fjalë, tha se shumë vërejtje të paraqitura nga anëtarët e kuvendit, po injorohen nga Drejtorja për Buxhet. Pastaj tha se i ka dërguar kërkesë për informatë kryetarit të komunës dhe drejtorit të Drejtorisë për Inspektime, lidhur me kapacitetet e burimeve njerëzore që i ka komuna, pasi që kryetari i komunës duhet të analizojë dhe të identifikojë defektet e kësaj përqindjeje të ulët të të hyrave në drejtoritë e caktuara. Po ashtu tha se komuna është dashtë të na informojë se çfarë po bën për ngritjen e kapaciteteve të saj të brendshme.

Isuf Jashari, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa- duke i referuar vërejtjeve të anëtarëve të kuvendit, paraqiti sqarime shtesë lidhur me informatën në fjalë, si dhe lidhur me vërejtjet e anëtarëve të kuvendit, dhe në fund shtoi se forma e raportimit është formë standarde për të gjitha komunat.

Bajram Beqiri, drejtor i Drejtorisë për Inspektime- paraqiti sqarime shtesë lidhur me të hyrat që inkason Drejtorja për Inspektime.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës- lidhur me të hyrat vetanake, tha se në cilësinë e kryetarit të komunës ka bërë maksimumin për një mobilizim të përgjithshëm për rritjen e të hyrave vetanake. Po ashtu tha se është pozitive që të gjitha projektet kapitale të planifikuara në vitin e kaluar për këtë vit, janë realizuar. Në fund lidhur me vërejtjen nga B.Jashari për kapacitet e burimeve njerëzore, tha se komuna ka mundësi të ndërrojë kuadro, atëherë kur dikush pensionohet, apo e lëshon punën, ose kur të vdes dikush.

Besim Jashari, anëtar i kuvendit- lidhur me trajnimin e stafit, tha se ekziston Instituti i Kosovës për Administratë Publike, prandaj është mirë të shfrytëzohet ajo mundësi, duke u identifikuar nevojat dhe të identifikohen se kush ka nevojë për trajnime të caktuara, dhe nëse pas marrjes së certifikatës për trajnimin e përfunduar, përsëri nuk e kryen punën siç duhet, atëherë duhet të vjen në shprehje përgjegjësia.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës- tha se për trajnime të stafit të komunës, kemi mbështetje nga USAID-i, nga Komisioni Evropian, si dhe nga Qeveria e Kosovës, prandaj nuk ka qenë e arsyeshme të hartohet një program për trajnimet e disa kuadrove të komunës.

Refik Ramaj, anëtar i kuvendit- reagoi lidhur me deklarinimin e drejtorit të DBF-së, ku tha se "mënyra e raportimit nuk është fontanë dëshirash, por është një formë standarde e raportimit", prandaj tha se deklarimi i tij është për keqardhje, dhe shtoi se ka dallim të madh në mes të raportit zyrtar dhe raportit intern apo menaxherial.

7. Shqyrtimi i Draft-Planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2013.

Besim Jashari, anëtar i kuvendit- duke i referuar planit të punës në fjalë, "Informata lidhur me gjendjen dhe mbrojtjen e pyjeve në K. e Vushtrrisë" e parashikuar në muajin nëntor, propozoi që kjo informatë të shqyrtohet në kuvend në muajin maj, me arsyetimin që me kohë të merren masat e nevojshme rreth parandalimit të djegies së pyjeve. Po ashtu propozoi që në muajin korrik "Njoftimi i kuvendit lidhur me raportin e Auditimit të Përgjithshëm për pasqyrat financiare", nëse ky raport arrin më herët, le të shqyrtohet në maj ose në qershor.

Zeqir Hasani, anëtar i kuvendit- duke i referuar planit të punës në fjalë, propozoi që për janar të jetë "Informatë për realizimin e të hyrave vetanake për periudhën e kuartalit të katërt", duke shtuar se ky propozim ndërlidhet me muajin dhjetor, pasi që në këtë muaj po diskutohet për dy muaj të të hyrave vetanake. Po ashtu propozoi që aprovimi i buxhetit të jetë e vetmja pikë e rendit të ditës, kurse për nëntor për "Informatën lidhur me numrin e bizneseve aktive dhe pasive", propozoi të riformulohet me këtë përmbajtje: "Informatë lidhur me strukturën e bizneseve, numrin e të punësuarve dhe zhvillimin e bizneseve".

Qazim Azemi, anëtar i kuvendit- lidhur me planin e punës në fjalë, tha se për arsim janë paraparë dy informata, prandaj propozoi që të jenë tri informata, njëra për përgatitjet e vitit shkollor, kurse dy tjerat për dy gjysmëvjetorët. Pastaj për çështjen e bujqësisë propozoi që të jenë dy informata. Gjithashtu propozoi që të ketë një informatë lidhur me dhënien në shfrytëzim të pronave bujqësore (komunale), se kujt iu janë dhënë, duke përfshirë sasinë dhe vendin ku janë dhënë. Mandej tha se është e nevojshme të jetë (në planin e punës) informata rreth punës së prokurimit dhe auditivit të brendshëm, në mënyrë që të informohemi se si menaxhohet paraja publike. Në fund propozoi që festivali "Takimet e Poeteshave Shqiptare" të jetë një datë të njëjtë për të gjitha vitet, dhe të njëjtën kërkesë e bëri edhe për "Javën e Hasan Prishtinës".

Refik Ramaj, anëtar i kuvendit- duke iu referuar planit të punës, paraqiti tri propozime që të përfshihen në planin në fjalë: Plani i strategjik i zhvillimit ekonomik; në muajin korrik të jetë një raport se sa është realizuar plani strategjik i zhvillimit lokal ekonomik (për periudhën janar-qershor, kurse për vitin 2014 të jetë raporti për realizimin e planit strategjik të zhvillimit lokal ekonomik për periudhën janar-dhjetor); në janar të përfshihet edhe një planifikim i përmirësimit të ambientit ndërmarrës në Vushtrri.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit- lidhur me planin e punës në fjalë, propozoi të ketë Informatë për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë në çdo kuartal apo dy herë brenda vitit. Pastaj tha se duhet të ketë informatë (në muajin maj apo qershor) për gjendjen e punimeve për fabrikën e ujit në fsh. Akrashticë. Gjithashtu duke iu referuar Informatës për ndërtimet dhe parandalimet e ndërtimeve të egra, tha se është në interesin e qytetarëve të komunës dhe në interesin e zbatimit të ligjit që krahas me këtë të jetë edhe kontrolli i kualitetit të ndërtimit dhe zbatimit të ligjit, duke shtuar se një informatë që e ka marrë nga Drejtoria për Urbanizëm, ku thuhet se prej vitit 2001 janë 19 objekte kolektive, dhe vetëm 3 objekte janë pranuar teknikisht, kurse 11 objekte nuk janë të pranuar, 3 janë në ndërtim e sipër, dhe 2 objekte janë pranuar pjesërisht.

Haki Maloku, përgjegjës i sekretarisë- paraqiti një propozim nga Drejtoria për Arsim, që të futet në planin e punës (në muajin mars ose prill) Draft-rregullorja për ndarjen e bursave për studentë.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Aprovohet Plani Vjetor i Punës së Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2013, duke inkorporuar edhe propozimet e anëtarëve të kuvendit.

8. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për vendosjen e ndriçimit publik në qytet dhe fshatra, në vendet ku ka participim nga ana e qytetarëve.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit- duke iu referuar propozim-vendimit në fjalë, tha se rrugica ka rrymë, e shtëpitë nuk kanë rrymë, prandaj më me prioritet është të kenë shtëpitë rrymë, sesa rrugicat. Gjithashtu pyeti se sa ka kapacitete për të ndriçuar rrugicat, kur nuk po ka kapacitete për furnizimin me energji elektrike të shtëpive. Pastaj edhe pse nuk është kundër, pyeti se sa është nevojë prioritare ndriçimi i rrugicave, në krahasim me nevojën e shtrirjes së ujësjellësit, shtruarjes së rrugëve në disa pjesë, sa ka kanalizime dhe ujëra të zeza që paraqesin rrezik për shëndetin dhe jetën e qytetarëve.

Sabit Kadriu, anëtar i kuvendit- lidhur me propozim-vendimin në fjalë, tha se ky është një luks, i cili nuk duhet lejuar tash për tash, pasi që ka fshatra që nga 5-6 orë nuk kanë energji elektrike, prandaj kjo çështje do të ishte mirë të mendohet për të ardhmen, pasi që të realizohen disa prioritete më të nevojshme sesa çështja në fjalë.

Prandaj propozoi që kjo çështje të prolongohet për vitet tjera, kur do të kemi kushte më të mira.

Veli Karaça, anëtar i kuvendit- tha se qëndrimi i Grupit parlamentar të LDK-së është që të përkrahen iniciativat e qytetarëve dhe shtoi se me mosvendosjen e ndriçimit publik në disa lagje, nuk bëhet kursim aq i madh, sa të ketë furnizim më të madh të qytetit të Vushtrrisë me energji elektrike. Pastaj tha se përveç që e përkrah propozim-vendimin në fjalë, ftoi të gjithë qytetarët që të ndërmarrin iniciativa që përmirësojnë mënyrën e jetesës së tyre, dhe përmendi si të nevojshme ndërmarrjen e një iniciative nga qytetarët për menaxhimin e mbeturinave, në mënyrë që të mos krijohen deponi ilegale nëpër fshatra.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit- tha se Grupi parlamentar i PDK-së e përkrah propozim-vendimin në fjalë, pasi që nevojat tjera të domosdoshme janë plotësuar.

Besim Jashari, anëtar i kuvendit- duke iu referuar nenit 4 të propozim-vendimit në fjalë, tha se ky nen është shumë me rëndësi dhe shtoi se çdo iniciativë e ndërmarrë nga qytetarët për përmirësimin e jetës së tyre duhet përkrahur, dhe njëkohësisht kërkoi që të shqyrtohen prioritetet.

Xhemajl Pllana, anëtar i kuvendit- lidhur me propozim-vendimin në fjalë, propozoi që të shqyrtohet alternativa përmes pllakave solare për ndriçim publik nëpër rrugica, pasi që këtë alternativë po e aplikojnë disa komuna.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës- tha se propozim-vendimi ka ardhur si rezultat i kërkesës së banorëve të fshatit Pestovë, pasi që ata janë në gjendje që me financimin e tyre ta instalojnë ndriçimin, kurse kanë kërkuar që në të ardhmen komuna t'i mbulojë shpenzimet. Po ashtu tha se nuk është vetëm fshati Pestovë, por ka edhe lagje tjera që janë të interesuara për ndriçimin publik. Në fund kërkoi që t'i shtohet një nen i ri propozim-vendimit në fjalë me këtë përmbajtje: "Të realizohet ndriçimi publik në ato lagje që i kryejnë obligimet ndaj komunës", sepse nëse paguajnë tatimin në pronë, kjo nënkupton se ata me të hollat e veta po e paguajnë.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 29 vota "për", 2 "abstenim" vendosi me sa vijon:

Me këtë vendim mundësohet vendosja e ndriçimit publik në qytet dhe fshatra aty ku kemi participim nga ana e qytetarëve.

Përparësi në realizimin e projekteve të ndriçimeve publike do të kenë komunitetet që participojnë më përçindje më të lartë.

Ndriçimi publik realizohet në ato lagje që kanë kryer (përmbushur) obligimet ndaj komunës.

Rrjeti i ndriçimit publik duhet të punohet në pajtim me normat teknike në fuqi, të përdoret material cilësor dhe pranimi teknik të bëhet nga Komisioni komunal.

9. Shqyrtimi i dy peticioneve: peticioni i grupit të qytetarëve kundër lejimit të ndërtimeve të larta, në kundërshtim me rregullat urbanistike dhe peticioni i banorëve të fshatit Stanoc i Poshtëm për parandalimin e ndërtimit të "Shtëpisë pushuese".

Idriz Ismajli, drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit- paraqiti sqarime shtesë lidhur me peticionet në fjalë.

Besim Jashari, anëtar i kuvendit- lidhur me peticionin e parë, tha se gjatë kontakteve që ka pasur me banorët e këtyre lagjeve, ka parë një shqetësim serioz, dhe ata kanë shprehur mllëfin e tyre që nuk po përfillen sa duhet si qytetarë në rastin e marrjes së vendimeve, të cilat i prekin ata në mënyra të ndryshme. Pastaj tha se ndërtimet e larta në kundërshtim me standardet është brengë e secilit, dhe shtoi se askush nuk është kundër ndërtimeve, por duke u respektuar normat dhe standardet për ndërtimet e larta.

Qazim Azemi, anëtar i kuvendit- lidhur me petitionin e parë, tha se përveç se kërkohet të përfillen standardet dhe kushtet e ndërtimit, duhet të merret edhe pëlqimi i banorëve të lagjeve, afër të cilave bëhen ndërtimet e larta, prandaj kërkoi që të merret parasysh peticioni i qytetarëve.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit- tha se objekti në fjalë është ndërtuar në bazë të planit urban, i cili është aprovuar në kuvendin e komunës.

Qazim Azemi, anëtar i kuvendit- replikoi duke shtuar se nëse një lagje pajtohet që t'i heqin shtëpitë njëkatëshe, për t'i ndërtuar shtëpitë 3 ose 4 katëshe, në këtë mënyrë është gjithçka në rregull, kurse vetëm një person nuk lejohet që në një lagje të ndërtojë banesë 10 katëshe, pa pëlqimin e fqinjëve.

Habib Mustafa, kryesues i kuvendit- tha se obligohet Sekretaria e Kuvendit që të përpilojë përgjigje me shkrim (në përputhje me dispozitat e Statutit të Komunës) për parashtruesit e dy peticioneve.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Për petitionin e parë:

Refuzohet si i pa bazë peticioni i banorëve të lagjeve: "Hakif Zejnullahu", "Haxhi Zeka", "Avni Rrustemi", "Vëllezërit Frashëri", "Shemsi Ahmeti", "Shaban Kapuqi" dhe Ganimete Tërbeshi" në Vushtrri, kundër ndërtimeve të larta siç është theksuar në peticion - në kundërshtim me rregullat urbanistike, standardet e ndërtimit, mbrojtjen e mjedisit si dhe ndalimin e ndërtimit në zonën në të cilën banojnë.

Për petitionin e dytë:

Kuvendi i Komunës konstaton se ndërtimi i atij objekti (pa prejdukuar destinimin e ndërtimit) nuk është i lejuar për shkak se në atë zonë është i ndaluar ndërtimi i çfarëdo lloji të objekteve, për faktin se është tokë bujqësore dhe nën masën e komasacionit.

Në lidhshmëri me të cekurat, kuvendi i komunës kërkon nga Drejtoria për Inspektime në Vushtrri që të ndërmer masa të menjëhershme ligjore për ndalim të ndërtimit të objektit të cilit i referohet peticioni.

10. Shqyrtimi i kërkesës së kryetarit të komunës për rishqyrtimin e vendimit nr. 297/12, dt. 30.10.2012.

Besim Jashari, anëtar i kuvendit- lidhur me rishqyrtimin e vendimit në fjalë, tha se kjo nënkupton që kryetari i komunës ose nuk është në nivelin e detyrës, ose po iu nënshtrohet diktatit, pasi që në mbledhjen kur është aprovuar propozim-vendimi në fjalë, janë paraqitur argumente të pamohueshme se me propozim-vendimin po bëhet shkelje e udhëzimit administrativ, por përkundër saj është hedhur në votim dhe është aprovuar. Pastaj tha se kërkesa për rishqyrtim ka ardhur, pasi që Grupi parlamentar i LDK-së e ka adresuar çështjen në MAPL, dhe pas shqyrtimit të fakteve, MAPL-ja ka konstatuar se është bërë shkelje nga kuvendi në rastin e aprovimit të vendimit në fjalë, ku shtoi se kjo është vërejtje për kryetarin e komunës, pasi që ka rënë në kundërshtim me ligjin.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës- tha se nuk pajtohet me udhëzimin administrativ, i cili ka përcaktuar që të mos jetë zëdhënësi i kryetarit të komunës anëtar i KKSB-së, pasi që është e nevojshme të jetë në KKSB, dhe shtoi se kërkesa e MAPL-së për rishqyrtim ka të bëjë vetëm për rastin e zëdhënësit të komunës.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet vendimi i KK-së 01 Nr. 297/12, dt. 30.10.2012, për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, si vijon: në paragrafin 1.1, nënpika e 19-të, në vend të Bahri Bivolakut-zëdhënës i komunës duhet të jetë Avni Deliu-korrespondent i Radio Kosovës për Komunën e Vushtrrisë.

11. Të ndryshme.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës- duke iu referuar kërkesës së S.Kadriut, paraqiti në pika të shkurta projektet e realizuara dhe rezultatet e arritura të qeverisë lokale gjatë vitit 2012.

Pajazit Pllana, anëtar i kuvendit- kërkoi informatë rreth mirëmbajtjes së rrugëve pas të reshurave atmosferike, pasi që ka qenë një situatë shumë e rëndë që ka krijuar rrethana të jashtëzakonshme dhe është krijuar një përshtypje se nuk është mirëmbajtur mirë dhe nuk është mbikëqyrur fare.

Besim Jashari, anëtar i kuvendit- lidhur me paraqitjen e projekteve dhe rezultateve të arritura nga kryetari i komunës për vitin 2012, paraqiti vërejtje që lëndët drusore në disa shkolla janë në oborr, dhe është shqetësuese që disa shkolla nuk kanë objekt deponimi të lëndëve djegëse, sepse kjo shkakton probleme në ngrohjen e objekteve shkollore, për shkak të lëndëve djegëse të lagështa. Gjithashtu paraqiti vërejtje për kryetarin e komunës, pasi që janë 6 shkolla (që 6 vite) në Komunën e Vushtrrisë që vazhdojnë të funksionojnë të paemëtuara.

Mbledhja përfundoi në orën 14:50.

Procesmbajtësi


Alban Tahiraj

Lektoroi


Vlora Krasniqi

Kryesuesi i Kuvendit


Habib Mustafa

